REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 940120
Datë/Datum. 30.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit 18.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 27.11.2020*	*Nr. i lëndës: 940/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:13.11.2020. OE **"Ora Engineering"Shpk** - Prishtinë.ka parashtruar ankesë me nr: 940/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **"Profitech"Shpk**-Prishtinë,lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me pjesë rezervë për MRRK për Turbinë"** me nr.prokurimi **KEK-20-4297-1-2-1**,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**"KEK" Sh.a**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:**Furnizim**,vlera e parashikuar e kontratës: **22,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 28 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 65 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 99 i LPP-së

Kerkesa per rishqyrtim dhe Ankesa prane OSHP-se eshte ne pajtim me afatet e nenit 108 dhe 109 te LPP-se dhe njeherit ne si OE ankues jemi"pale e interesuar"per kete procedure te prokurimit sipas Nenit 4 Pika 26 te LPP-se,sepse jemi te pergjegjshem dhe OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem dhe ne baze te renditjes se Proceverbalit te hapjes me kthimin e lendes ne rivlersim duhet te shpallemi fitues.

Ne pajtim me Rregullat per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane Autoriteteve Kontraktuese. parashtrim te ankesave prane OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, Neni 9 Paragrafi 2 "Ankesa do te dorezohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njekohesisht. nje kopje e ankeses do t'i dorezohet Autoritetit Kontraktues.Pretendimet ankimore duhet te jene te njejta me ato te paraqitura ne **Autoritetin** Kontraktues". njoftojme Eksperti shqyrtues/Tekniki Profesional dhe Paneli shqyrtues te OSHPse se pretendimi ankimor i meposhtem eshte i njejte dhe identik sikur ne Kerkesen per rishqyrtim te paraitur me date 02.11.2020 prane AK "KEK". Per me shume referojuni tekstit te meposhtem:

Ne, ORA Engineering pas marrjes se njoftimit per vendimin e AK-se per te na shpallur si ofertues te papergjegjshem,ankohemi se vlersimi nga AK ka qenejo i drejte.Me poshte po paraqesim argumentet tona pse jemi te pergjegjsem ndersa OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem:

1. Ne kemi ofruar aurotrizim per te gjitha produketet e Megitt-it duke perfshire ketu edhe pozicionin Nr 3, Modul shenderrues Megitt Sensorex. Siq shihet edhe nga vet emri i produktit kemi te bejme me prodhuesin Megitt me baze ne Zvicer.Autorizimi jone vlene per te tre produketet e Megitt-it (Poz 1,2 dhe 3).

Sqarim shteese: Te bashkangjitur gjeni linkun https://eee.meggitt.comabout-use/our company locations dhe nje fotodeshmi e cila deshmon qe Fabrika Megitt ne France eshte pjese e Megitt me baze ne Zvicer.

2. Per Pozicionin Nr.4 komisioni i vleresimit ka konstatuar qe ne nuk kemi ofruar certifikate adekuate per produktin e ofruar. Me lejoni te ju njofoftoj se ne kemi ofruar ISO 9001 certifikaten e prodhuesit OEM per produktin e ofruar. Pra, IMI CCI (ish-SULZER) eshte prodhues i vetem origjinal i paisjeve te kerkuara per pozicionin Nr.4. Kete mund ta verifikoni me prodhuesin. Paisja ne fjale eshte e te njejtit prodhues qysh prej instalimit te TCB-se.
Sqarim shtese: *Per shkak se AK gjate fazes se vleresimit te ofertes ka pasur paqartesi lidhur me cetifikaten e prodhuesit IS09001 eshte dashur te veproje ne pajtim me Nenin 59 dhe 72 te LPP-se duke kerkuar Informata shtese tek Prodhuesi IMI CCI (ish-Sulzer).Keto dy dispozita ligjore paraqiten te nevojshme per AK pershire KEK kur ka paqartesi lidhur me dokumentat e dorezuar ne oferte.ISO Certifikaten e gjeni te bashkangjitur.Paisja ne fjale eshte pjese e tubit te Valves qe e prodhon gjithashtu IMI CCI (ish- SULZER). Gjithashtu sqarojme qe ish-SULZER ne Zvicer eshte ndare ne dy pjese dhe pjesa hidraulike (valvat) i eshte shite kompanise CCI e tash CCI quhet IMI CCI dhe ka te gjitha te drejtat autoriale te brendeve.Te bashkangjitur gjeni linkun qe sqaron nje gje te tille si dhe nje fotodeshmi.*

OE i rekomanduar per kontrate i papergiegjshem

3. Pas shqyrtimit te ofertes se OE te rekomanduar per dhenje te kontrates,se produkti i ofruar se pari eshte fallsifikim,ai mban emrin identik RSG 10+4K me emrin brendit te prodhuesit origjinal IMI CCI (ish-SULZER) e pastaj produkti i ofruar nuk ploteson kerkesat teknike sipas dosjes se tenderit.
Sqarim shtese: *Per shkak se eshte keqperdorur produkti i prodhuesit origjinal te paisjes speciale RSG 10+4K nga OE"Profitech ",AK gjate fazes se vleresimit dhe pas kerkeses per rishqyrtim qe te kerkoje Informata shtese apo sqarime nga Prodhuesi origjinal i paisjes se Instaluar ne TCB nga IMI CCI (ish-SULZER) se produkti i ofruar nga Prodhuesi indian a i eshte keqperdorur Vizatimi teknik (Katalogu) i*

brendit te tyre

Produkti i prodhuesi indian teknikisht i papergjegjshem

Siq mund te shihni ne vizatimin e bashkangjitur ku krahasohen produkti i ofruar me produktin e kerkuar,verehen se dimenzionet e kyqjes se komplet njesise se Feedbacktransmitterit nuk jane te njejta me produktin e kerkuar ne dosjen e tenderit. Pinat perforcues te Feedback transmitterit te ofruar siq mund te shihet ne vizatimin e ofruar nga Profitech jane me te shkurter se sa te produktit origjinal.Te bashkangjitur krahasimin e vizatimeve ne mes te vizatimeve te ofruara dhe atyre te kerkuara te Specifikimet teknike te detyrueshme ANEX 1 .

Ju njoftojme se Prodhuesi IMI CCI deklaron se Produktet e kompasnise indiane nuk mund te inkorporohen neTubin e valvave rregulluese te TCB.Ne rast se ju megjithate vendosi ne favor te produktit te fallsifikuar ne jemi te obliguar te njoftojme Doganant e Kosoves dhe Inspektoratin e Tregut per bllokimin e produkteve te fallsifikuara dhe si rrjedhoje Kontrata nuk do te mund te implementohet. Te bashkangjitur mund te gjeni Letren sqaruese te Prodhuesit origjinal te RSG IO+4K IMI CCI (Sulzer) produktit per Poz.4.

KOMENT

Pas pranimit te pergjigjes mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim si te pabazuar kemi vrejtur se ne arsyetim mungon pergjigjja nga njesia e kerkeses lidhur me pretendimin tone ankimor se OE Profitech eshte i papergjegjshem ne aspektin teknik.

KERKOJME

TE APROVOHET ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne rivleresim.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1.. Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues

Evidenca 1 Autorizim nga prodhuesi, për shitjen e produkteve qe ofroni

Kërkesa 2.. Certfikata e kualitetit

Evidenca 2 Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001)

Kërkesa 3.. Mostra të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen

Evidenca 3 Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatim te vërtetuar nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut dhe apo vizatim sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i vlerësimit gjatë fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tënderëve nga tri (3) ofertat e pranuara vetm një ofertën e OE " Profitech"Shpk ka shpallur të përgjegjshme të cilën e ka rekomanduar për kontratë e cila ka ofruar edhe çmimin më të lirë në vlerë prej 7,643.45 €.

Sa i përket ofertës së OE ankues "Ora Engineering"Shpk,komisioni e ka vlerësuar si ofertë të papërgjegjshme me arsyetimin se tek pozicioni nr.3 nuk ka ofruar autorizim nga prodhuesi MEGGITT SENSOREX për transimterin e pozitës së ofruar.Ekziston vetëm autorizimi për MEGGITT SA e që është prodhues i sensorëve të kërkuar në pozicionin 1 &2.
Pozicioni 4:ISO Standardi i firmës IMI CCI për produktin e ofruar në këtë pozicion nuk potencohet se firma në fjalë është prodhues i senzorave tq pozitës(transimterave të pozitës) por vetëm potencohet se është prodhues i valvave servis,valvave të kontrollit dhe valvave siguruese.
Oferta e OE akues është oferta më e shtrenjtë e cila është në vlerë prej 21,437.06 €

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ORA ENGINEERING"SHPK

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ora Engineering"Shpk,se AK gjate fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka ofruar autorizim për pozicionin nr.3 nga prodhuesi MEGGITT SENSOREX për transmiterin e pozitës të tipit SENSOREX SX312,që sipas OE ankues Autorizimi i ofruar përfshin edhe pozicionin nr.3,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ofroj autenticitetin e produkteve dhe cilësisë reprezentuese,e dëshmuar me autorizim nga prodhuesi, për shitjen e produkteve qe ofroni.

OE ankues "Ora Engineering"Shpk në oferten e tyre ka dorëzuar edhe autorizimin nga prodhuesi MEGGITT për pozicionet/produktet 1,2 dhe 3 të kërkuar sipas dosjes se tenderit.
Gjithashtu OE ankues ka dorëzuar edhe katalogun për produktin/pozicionin nr.3 të prodhuesit MEGGITT dhe specifikat e produktit në katalog SENSOREX SX312 janë të njejta me specifikat e produktit të kërkuar në Ankesin 1 të specifikimeve teknike në dosjen e tenderit.
Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i AK-së, se prodhuesi MEGGITT nuk prodhon transmitera të pozitës Sensorex është i paqëndrueshëm sepse në Web faqe të kësaj kompanie ekziston ky lloj produkti,andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se për pozicionin nr.4 tek ISO Standardi i firmës IMI CCI për produktin e ofruar në këtë pozicion nuk potencohet se firma në fjalë është prodhues i senzorave të pozitës (transmiterave të pozitës) por vetëm potencohet se është prodhues i valvave servis,valvave të kontrollit dhe valvave siguruese,që sipas OE ankues çertifikata ISO 9001:2015 për produktin e ofruar për pozicionin 4 e prodhuesit IMI CCI (ish Sulzer) është konform kërkesës së dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues sqaron se përshkrimi në çertifikatën e prodhuesit IMI CCI nuk përputhet me përshkrimin e pozicionit nr.4 të kërkuar në dosje të tenderit. OE ankues ka dorëzuar katalogun për pozicionin nr.4 të prodhuesit IMI CCI ku specifikat në katalog janë të njejta me specifikat të kërkuara në Ankesin 1 të specifikimeve teknike në dosjen e tenderit.AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime apo dëshmi shtesë nga OE lidhur me këtë pretendim.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Profitech"Shpk për pozicionin nr 4. ka ofruar produkt të fallsifikuar i cili mban emrin identik RSG10+4K të prodhuesit orgjinal IMI CCI (produkt i ofruar nga OE ankues me këtë prodhues) dhe sipas OE ankues,OE i rekomanduar për kontratë duhej të shpallej i papërgjegjshëm,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Ankesin 1.të specifikacionit teknik të dosjes së tenderit për pozicionin nr.4 është kërkuar produkti me përshkrim "Transmiter komplet pozite R-SG10+4K: feedback: 4-20 mA për valvat kontrolluese. Transmiteri duhet të kete edhe mikro-switchat për sinjalizimin e pozitave fundore (OPEN/CLOSE) ose ekuivalent". OE i rekomanduar për kontratë për këtë produkt ka ofruar një katalog nga prodhuesi Indian Iyappan Engineering Industries Private Limited.Specifikat e produktit të ofruar janë identike me specifikat e kërkuara në Ankesin 1 të specifikimeve teknike.Pretendimi i OE ankues se produkti i ofruar është i falsifikuar për ekspertin shqyrtues ky pretendim nuk qëndron sepse OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për këtë pretendim.Katalogu i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin nr.4 është i njejtë me specifikat e kërkuara dhe nuk është në përgjegjsi të ekspertit shqyrtues të verifikoj nëse vizatimi teknik (katalogu) i produktit të OE të rekomanduar për kontratë është i fallsifikuar dhe është marre nga brendi i produktit të OE ankues.

Pretendimi ankimor është i pabazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë "Profitech"Shpk është e përgjegjshme dhe është dukshëm më e lire sesa oferta e e OE ankues,andaj rekomandoj që AK të vazhdoj me lidhjen e kontratës.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e pjesërisht e bazuar**,dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me lidhjen e kontratës

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KEK
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – ORA ENGINEERING"SHPK